


Aksidentet Rrugore

Mars 2019

Tiranë, më 23 Prill 2019: Në muajin Mars 2019 numërohen 127 aksidente rrugore nga 123 aksidente të ndodhura në Mars 2018, duke u rritur me 3,3 % krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Fig. 1 Aksidentet rrugore mujore, Mars 2015 – Mars 2019



Në Mars 2019, numri i të aksidentuarve (të vrarë dhe të plagosur) është 176 persona nga 160 që ishte një vit më parë, duke u rritur me 10,0 %. Numri i të aksidentuarve në tremujorin e parë të vitit 2019, është 483 duke mos patur ndryshim krahasuar me të njëjtën periudhë të 2018.

Në muajin Mars 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 24 persona nga 14 që ishte një vit më parë. Në tremujorin e parë 2019, numri i të vdekurve nga aksidentet rrugore është 48 nga 47 që ishte një vit më parë.

Në Mars 2019, aksidentet rrugore, në 82,7 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së drejtuesit të mjetit. Numri më i lartë i aksidenteve në këtë periudhë është kryer nga grup mosha 25 –35 vjeç, duke zënë 25,2 % të numrit të aksidenteve gjithsej. Aksidentet në këtë grup moshe janë ulur me 22,0 %, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Në tremujorin e parë 2019, aksidentet rrugore, në 16,3 % të rasteve, kanë ndodhur si pasojë e sjelljes së këmbësorit. Gjatë kësaj periudhe, numri i aksidenteve sipas sjelljes së këmbësorit është ulur 27,5 %, krahasuar me një vit më parë.

Tab. 1 Aksidentet rrugore

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Të plagosur	
	Gjithsej	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	
Mars-2018	123	2	12	53	93	
Mars-2019	127	9	15	44	108	
Ndryshimi vjetor (%)	3,3	350,0	25,0	-17,0	16,1	
Janar–Mars 2018	370	9	38	133	303	
Janar–Mars 2019	356	16	32	131	304	
Ndryshimi vjetor progresiv	-3,8	77,8	-15,8	-1,5	0,3	

Tab. 2 Aksidentet rrugore, sipas përdoruesve të rrugës

Periudha	Aksidente sipas		Të vdekur	
	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve	Sjellja e Drejtuesit të Mjetit	Sjellja e Këmbësorëve
Mars-2018	94	29	10	4
Mars-2019	105	22	21	3
Ndryshimi vjetor (%)	11,7	-24,1	110,0	-25,0
Janar –Mars 2018	290	80	36	11
Janar –Mars 2019	298	58	44	4
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	2,8	-27,5	22,2	-63,6

Tab. 3 Aksidentet rrugore, sipas moshës së drejtuesit të mjetit

Periudha	Moshë					Larguar nga vendi i ngjarjes
	0 - 25 vjeç	25- 35 vjeç	35- 45 vjeç	45-60 vjeç	60+ vjeç	
Mars-2018	20	41	26	26	6	4
Mars-2019	31	32	27	25	11	1
Ndryshimi vjetor (%)	55,0	-22,0	3,8	-3,8	83,3	-75,0
Janar–Mars 2018	75	101	67	76	23	28
Janar–Mars 2019	80	98	71	64	27	16
Ndryshimi vjetor progresiv (%)	6,7	-3,0	6,0	-15,8	17,4	-42,9

Tab. 4 Aksidentet rrugore sipas qarqeve

Periudha	Aksidente		Të vdekur		Aksidente		Të vdekur	
	Mars 2018	Mars 2019	Mars 2018	Mars 2019	Janar – Mars 2018	Janar – Mars 2019	Janar – Mars 2018	Janar – Mars 2019
Shqipëria	123	127	14	24	370	356	47	48
Tiranë	56	49	3	2	170	153	11	6
Durrës	23	12	4	3	57	33	8	8
Shkodër	2	4	1	4	8	6	9	5
Elbasan	5	6	1	2	23	19	7	5
Fier	5	9	0	3	13	29	2	8
Vlorë	11	11	1	2	23	22	1	3
Korçë	3	9	0	1	9	18	0	2
Lezhë	10	12	0	2	35	42	2	3
Berat	4	3	1	1	12	7	1	2
Kukës	1	2	0	0	4	8	2	1
Diber	2	3	2	3	8	4	3	4
Gjirokastër	1	7	1	1	8	15	1	1

Përkufizime

Aksidente: Aksidentet rrugore që ndodhin tek një ose më shumë persona që goditen nga mjetet e qarkullimit rrugor.

I vdekur: I vdekur nga aksidenti në rrugë quhet çdo person i cili ka vdekur menjëherë ose brenda 30 ditëve si rezultat i aksidentit.

I plagosur: I plagosur konsiderohet çdo person, i cili nuk ka vdekur por ka marrë plagë të lehta apo të rënda si rezultat i aksidentit.

Sjellja e Drejtuesit të Mjetit : Nënkupton nëse drejtuesi i mjetit nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si: frenim i papritur, mosrespektimi i shenjave (sinjalistikës) së trafikut, mosrespektimi i normave të shpejtësisë, etj.

Sjellja e Këmbësorëve: Nënkupton nëse këmbësori nuk zbaton rregullat e qarkullimit rrugor sipas "Kodit Rrugor" si : kalim rruge pa kujdes, etj.

Burimi i të dhënave: Të dhënat janë siguruar nga Ministria e Punëve të Brendshme/Drejtoria e Policisë së Shtetit.

Të dhënat e muajit të fundit mbi Personat e vdekur nga aksidentet rrugore janë paraprake dhe subjekt rishikimi. Për më shumë, referohu: <http://www.instat.gov.al/al/rreth-nesh/cilesia-statistikore.aspx/> Politika e revizionimit statistikor.